



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2024:119395

Datë: 25.03.2025

Numri i dokumentit: 07038661

C.nr.74/24

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË NOVOBËRDË, përmes gjyqtarit Gazmend Ajvazi, me bashkëpunëtoresh profesionale Laureta Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.S. nga fshati K.E, komuna N., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sevdail Robelli, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Departamenti i Shpronësimit, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti pagesën e kamatës, vlera e kontestit 9.846.87 euro, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor dhe publik më datë 25.03.2025 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit M. Snga fshati K.E, komuna e N. dhe **detyrohet** e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Departamenti i Shpronësimit që në emër të kamatës ligjore prej 7%, e kalkuluar për shumën në lartësi prej 9.846.87€, t'ia paguajë paditësit shumën prej **4.633.25** Euro, për periudhën kohore nga data 30.12.2021 deri me datë 09.10.2023, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Refuzohet e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit e kërkuar më tepër se shuma e aprovuar si në pikën I të këtij dispozitivi, edhe atë sa i përket kamatës ligjore prej 7% për periudhën kohore nga data 30.12.2019 deri me datë 30.12.2021, përkatësisht në shumën prej **5.213.62** €.

III. Detyrohet e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguaj paditësit shumën prej 584.00 €, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

Arsyetim

Paditësi, përmes të autorizuarit të saj, më datë 23.04.2024 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për pagesën e kamatës, vlera e kontestit 9.846.87 euro.

Në padi ka theksuar se paditësi inicon procedurën kontestimore lidhur me pagesën e kamatës në bazë të autorizimit të dhënë nga gjyshi i tij i cili është pronarë i parcelave ...dhetë cilat gjenden në ZKe të cilat nga e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës janë shpronësuar për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë. Tutje ka theksuar se e paditura me datën 19.10.2023 ka bërë pagesën e shumës prej 37.240.00 në llogarinë bankare të paditësit sipas autorizimit nga gjyshi i tij, pra ka bërë vetëm pagesën e shumës sipas aktit të vlerësimit pa llogaritur kamatën vjetore prej 7%. Gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar duke i specifikuar.

I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se mbesin pranë kërkesëpadisë së paditësit si dhe precizimit të saj, nga gjykata ka kërkuar që padia të aprovohet në tërësi si e bazuar për shkak se e paditura në kundërshtim me ligjin 03/L-139 nenit 16 par.2.1 dhe 2.2, nuk i ka kryer obligimet me kohë respektivisht është vonuar për periudhën prej 3 vite e 11 muaj që paditësve t'ia paguajë shumën prej 37,240.00€, për shkak të shpronësimit të 2 parcelave dhe atë të gjitha këto në ZK-..... Përfaqësuesi i paditësit në seancën e datës 19.03.2025, ka bërë precizimin e padisë duke kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën që në emër të kamatës ligjore prej 7%, e kalkuluar për shumën në lartësi prej 37.240.00€, t'ia paguajë paditësit shumën prej 9846.87 Euro, për periudhën kohore nga data 30.12.2021 deri me datë 09.10.2023.

Shpenzimet i ka kërkuar në lartësi prej 584.00€ që përfshijnë përpilimin e padisë shumën prej 104€, dy seanca me nga 135€, pagesën për ekspertin financiar prej 150€ si dhe taksën gjyqësore prej 60€.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancën e datës 19.03.2025 si dhe në fjalën përfundimtare, duke theksuar se ngastra objekt shpronësimi është përfshirë në shpronësim me Vendimin Përfundimtar nr.09/115 të datës 17.12.2019 dhe paditësja është kompenzuar brenda afatit prej 2 vitesh bazuar në nenin 7 të Vendimit të cekur më lartë, si dhe duke marrë parasysh nenin 16 parag. 6 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së paluajtshme, ku parashihet se “shuma e kompensimit të shpronësimit e përcaktuar me Vendim Përfundimtar paguhet plotësisht brenda 2 viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit”, ka konsideruar se kërkesëpadisë së paditëses i mungon baza ligjore, gjykatës i ka propozuar që të refuzohet kërkesëpadia e paditëses në tërësi si e pabazuar.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova: Akti i vlerësimit i dt.26.11.2018 për ngastrën ..., Akti i vlerësimit i dt.26.11.2018 për ngastrën ...Gjendja e llogarisë për nga ... për periudhën kohore nga 02.10.2023 deri m dt.26.12.2023 e dt.26.12.2023,Vendimi përfundimtar 9/115 i dt.17.12.2019 bashkangjitur edhe të dhënat sipas elaboratit të MMPH-së, si dhe administrohet ekspertiza e financave dt.16.12.2024.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, pasi që:

Nga Akti i vlerësimit i dt.26.11.2018 për ngastrën ..., gjykata ka gjetur se pjesa e paluajtshmërisë së shpronësuar është në sipërfaqe prej 949 m² dhe është vlerësuar nga Zyra për Vlerësimin e pronës së paluajtshme 8.00€ për m², andaj vlera e përgjithshme të kësaj pjese të ngastrës është vlersuar në shumën prej 7.592.00 €.

Nga Akti i vlerësimit i dt.26.11.2018 për ngastrën, gjykata ka gjetur se pjesa e paluajtshmërisë së shpronësuar është në sipërfaqe prej 1853 m², dhe është vlerësuar nga Zyra për Vlerësimin e pronës së paluajtshme 16.00€ për m², andaj vlera e përgjithshme të kësaj pjese të ngastrës është vlersuar në shumën prej 29.648.00 €.

Nga Gjendja e llogarisë për ... nga ... per periudhën kohore nga 02.10.2023 deri me 26.12.2023 e dt.26.12.2023, gjykata vërtetoi faktin se me dt.09.10.2023 është bërë Transferi nga Thesari i Kosovës me nr. Referencësnë shumë prej 37.261.73 në llogarinë e

Sipas vendimit përfundimtar nr.09/115 te datës 17.12.2019, gjykata vërtetoi faktin se organi shpronësues Qeveria e Republikës së Kosovës, MMPH – Departamenti i Shpronësimit ka miratuar shpronësimin për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i projektit të infrastrukturës – ndërtimi i autostradës Prishtinë – Gjilan – Dheu i Bardhë, segmenti Banullë – Bresalc, e që preken Komuna e Graqanicës, Komuna e Lipjanit dhe Komuna e Gjilanit, respektivisht zonat kadastrale Bresalc – Ponesh dhe Zhegovc, sipas nenit 7 të këtij aktvendimi është paraparë periudha kohore brenda 2 viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit Departamenti i Shpronësimit në kuadër të MMPH-së, do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit të përcaktuar në këtë vendim.

Nga ekspertiza e financave dt.16.12.2024 e përpiluar nga eksperti financiar Behar Salihu gjykata ka vërtetuar faktin se kamata vjetore prej 7% për shumën prej 37.240.00€uro e llogaritur prej datës 30.12.2019 deri me 09.10.2023 është në shumë prej 9.846.00 €uro, ndërsa gjatë dëgjimit të tij në seancën e datës 19.03.2025 i njëjti ka deklaruar se për periudhën kohore pas kalimit të dy viteve që është dashur të paguhet shuma e kompensimit për ngastrat e shpronësuar dhe është një periudhë kohore prej 21 muaj e 10 ditë dhe se ka llogaritur që për këtë periudhë kohore shumën prej 4.633.25 €uro, kjo periudhë kohore është nga 30.12.2021 e deri me 09.10.2023.

Baza juridike

Sipas nenit 16 të Ligjit Për Shpronësim, me të cilin është rregulluar pagesa lidhur me kompensimin ku është paraparë se, *“kompensimi paguhet në Euro ose një valutë tjetër që mund të këmbëhet lirisht. 2. Organi Shpronësues ia paguan, ose kërkon nga parashtruesi i kërkesës ose Përfituesi i pritur – nëse ka të këitillë – që t’ua paguajë shumën e kompensimit të përcaktuar në Vendimin Përfundimtar, Pronarit të prekur ose Zotëruesit të Interesit. Kompensimi i kërkuar në Vendimin Përfundimtar do të jetë: 2.1. shuma e përcaktuar në aktin përkatës të vlerësimit plus; 2.2. interesi në atë shumë i cili është akumuluar duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të Vendimin Përfundimtar deri në datën e pagesës. Ky interes akumulohet në shkallë prej shtatë përqind (7%) interes i thjeshtë vjetor dhe kapitalizohet në bazë vjetore.*

Sipas paragrafit 6 të nenit 16 të Ligjit Për Shpronësim është paraparë afati kohor i pagesave ku thuhet “*Shuma e kompensimit të shpronësimit e përcaktuar në Vendimin Përfundimtar paguhet plotësisht brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit. Nëse kompensimi nuk paguhet brenda kësaj kohe, Personi i cili është dashur të pranojë kompensimin mund të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente për të kërkuar nxjerrjen e një urdhri për revokimin ose anulimin e këtij vendimi*”.

Gjithashtu kamata ligjore është e rregulluar edhe nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vlerësimet përfundimtare të gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të administruara, si dhe fakteve jokontestuese në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëseve, pasi që në bazë të provave të administruara, Vendimit Përfundimtar me nr. 09/115 të datës 17.12.2019, ku në nenin 7 të këtij Vendimi është paraparë afati kohor prej 2 viteve për pagesat që Organi Shpronësues u’a bënë pronarëve të pronave të shpronësuara, e gjithashtu pronarët e ngastrave – paditëset nuk kanë ushtruar ndonjë ankesë sa i përket pikës 7 të këtij Vendimi, por ankesa ndaj shumës së kompensimit që është ushtruar nga paditësit ka pasur të bëjë vetëm me ankesën - pakënaqësitë lidhur me shumën e kompensimit. Afati kohor prej 2 viteve ka qenë edhe në pajtueshmëri me paditëset për faktin se të njëjtat nuk kanë ushtruar ankesë lidhur me afatin kohor, andaj edhe nuk ka rrjedhë kamata ligjore prej 7%, pasi që Organi Shpronësues nuk ka qenë në vonesë. Pas kalimit prej 2 viteve Organi Shpronësues është gjindur në vonesë andaj edhe ka filluar të rrjedhë kamata ligjore prej 7%, përkatësisht nga data 30.12.2021, e cila përfshin periudhën deri me datën 30.07.2022.

Gjithashtu ky vlerësim i gjykatës gjen mbështetje edhe në nenin 16 paragrafi 6 të Ligjit Për Shpronësim, andaj gjykata vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Pretendimi i përfaqësuesit të paditëseve se Vendimi Përfundimtar është nxjerrë në kundërshtim me ligjin nuk qëndron pasi që Vendimi Përfundimtar është në përputhje të plotë me Ligjin Për Shpronësimin, e i cili në mënyrë specifike e rregullon edhe kamatën ligjore në shkallën prej 7 % në vit.

Gjykata deri te ky vlerësim erdhi duke marrë për bazë edhe ekspertizën e ekspertit financiar, i cili ka kalkuluar kamatën ligjore prej 7 %, sipas pretendimeve të paditëseve për shumën prej 37.240.00€uro, për periudhën kohore nga data 30.12.2019 e deri me 09.10.2023, ku nga llogaritjet ka rezultuar shuma prej 9.846.87 €uro, si kamatë ligjore për periudhën e lartcekur dhe të shumës së lartcekur. Gjykata e aprovoi pjesërisht shumën prej 4.633.25€uro, për periudhën kohore prej 21 muaj e 10 ditë edhe nga atë nga data 30.12.2021 deri më 09.10.2023, kur edhe është gjindur në vonesë Organi Shpronësues e paditura MMPH, ndërsa refuzoi shumën prej 5.213.62 €uro si të pa bazuar, për shkak se kamata ligjore prej 7 % nuk ka rrjedhur në periudhën kohore 30.12.2019 deri me datë 30.12.2021.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur në bazë të suksesit të paditësit në procedurë, e duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së, ashtu që i ka aprovuar shpenzimet e kërkuara nga i autorizuari i paditësit, dhe e ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj

Numri i lëndës: 2024:119395
Datë: 25.03.2025
Numri i dokumentit: 07038661

shpenzimet e procedurës, edhe atë: në emër të përpilimit të padisë për shumën prej prej 104€, taksën për padi 60€, shpërblimin për 2 përfaqësime 1x135€, për ekspertizën shumën prej 150€, totalin prej 584.00 Euro të gjitha këto në kuadër të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj, bazuar në dispozitat e lartcekura dhe konform nenit 143 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NE NOVOBERDE
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.74/2023, më datë 24.03.2025

Gjyqtari,
Gazmend Ajvazi

UDHËZIMI JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate.